

V E N D I M
Nr.185, datë 26.11.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija VuciAnëtar i	'''
Gjergj SauliAnëtar i	'''
Alfred KaramuçoAnëtar i	'''
Kujtim PutoAnëtar i	'''
Kristofor PeçiAnëtar i	'''
Sokol SadushiAnëtar i	'''
Petrit PlloçiAnëtar i	'''
Tefta ZakaAnëtar e	'''

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 19.10.2001 dhe 29.10.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.151 Akti që i përket:

KËRKUES: SHOQATA KOMBËTARE E TË SHPRONËSUARVE "PRONËSI ME DREJTËSI", përfaqësuar nga avokat Agim Tartari.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.
2. DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE, përfaqësuar nga Elsa Myslymi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.12, datë 7.1.1999 të Këshillit të Ministrave "Për objektet që do të mbeten në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare".

Kërkuesi, për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.12, datë 7.1.1999 si të papajftueshëm me Kushtetutën, parashtron këto shkaqe:

-Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.12, datë 7.1.1999 vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe konkretisht me nenin 100/4 të saj, sipas të cilit "aktet e Këshillit të Ministrave janë të vlefshme kur nënshkruhen nga Kryeministri dhe Ministri propozues". Nga Fletorja Zyrtare nuk rezulton që Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Koordinimit Qeveritar të ketë nënshkruar këtë vendim.

-Vendimi i Këshillit të ministrave nr.12, datë 7.1.1999 nuk është nxjerrë në bazë e për zbatim të ndonjë ligji të veçantë, në kundërshtim me nenin 118/1 të Kushtetutës, sipas të cilit "aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve...".

-Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.12, datë 7.1.1999 vjen në kundërshtim me parimet e neneve 41 dhe 42 të Kushtetutës.

Në këtë rast ndodhemi para një akti me karakter zhveshës nga e drejta e pronësisë, sepse vendimi nuk parashikon asnjë shpërblim për pronarin dhe nuk merr parasysh të drejtat e tij.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Tefta Zaka, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi, Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarve "Pronësi me Drejtësi", ka parashtruar se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.12, datë 7.1.1999 "Për objektet që do të mbeten në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare" vjen në kundërshtim me nenet 41, 42, 100/4 dhe 118/1 të

Kushtetutës, sepse nuk është nënshkruar nga ministri propozues, nuk ka dalë në bazë e për zbatim të ndonjë ligji të veçantë dhe cenon të drejtën themelore të pronësisë.

Gjithashtu, sipas kërkesit, objektet e parashikuara në listën bashkëngjitur vendimit të Këshillit të Ministrave i kanë kaluar në administrim Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, duke i mohuar pronarëve të tyre të drejtën e pronësisë dhe duke mos parashikuar asnjë shpërblim për këta pronarë.

Gjykata Kushtetuese, pas shqyrtimit të çështjes, arriti në përfundimin se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.12, datë 7.1.1999 "Për objektet që do të mbeten në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare" është një akt administrativ me karakter individual dhe në kuptim të nenit 131/c të Kushtetutës çështja nuk është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Në bazë të nenit 131 shkronja "c" të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare pra, për akte të cilat vendosin norma të përgjithshme, abstrakte dhe që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, që i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektsh.

Në rastin konkret, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.12, datë 7.1.1999 është një akt administrativ me karakter individual, sepse rregullon marrëdhënie konkrete për një çështje të caktuar dhe i shtrin efektet e tij në një kategori të caktuar subjektsh.

Gjithashtu, ky qëndrim harmonizohet dhe me Kodin e Procedurës Civile, në nenin 326 të të cilit parashikohen rastet kur nuk mund të ngrihet padi në gjykatën e zakonshme, duke përfshirë edhe kategorinë e akteve administrative me karakter normativ të Këshillit të Ministrave, si dhe aktet administrative që, sipas Kushtetutës, janë në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 134 të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.